



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE  
BUJQËSORE Shkoder**

**PLAN INTEGRITETI 2025-2027**

**Miraturar me Urdhrin e Brendshëm nr.17/1, date 30.05.2025 të Titullarit të Institucionit**

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Institucionin e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Shkoder.

Ky plan u realizua nga Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit, ngritur me Urdhrin nr.17, date 26.05.2025 të Titullarit të Institucionit, si vijon:

Koordinator/Kryetar: Kostandin Hajkola, Drejtor i Drejtorisë së Teknologjive Bujqësore, Anëtar Arzen Rexha, Përgjegjës Sektori i Farërave dhe Laboratorit. Anëtarë Mirash Markaj Përgjegjëse Sektori i Financës dhe Sherbimëve Mbështetëse.

Ky Plan Integriteti është hartuar në përmbushje të objektivit specifik A9”Forcimi I integritetit të nëpunësve publikë,specifikisht masa A.9.4”Hartimi,miratimi dhe zbatimi i planeve të integritetit nga të gjitha institucionet e varësive të ministrive”,me afat zbatimi viti 2025, të Planit të Veprimit 2025-2027 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit miraturar me VKM nr.247, datë 20.03.2015, të ndryshuar. Këto objektiva parashikojnë përdorimin sistematik të mekanizmit për evidentimin e hapësirave për korrupsion dhe forcimin e integritetit të nëpunësve publikë, nëpërmjet vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit, miratimit e zbatimit të planeve të integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

|                                                    |  |
|----------------------------------------------------|--|
| TABELA E PËRMBAJTJES                               |  |
| DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL.....        |  |
| LISTA E SHKURTESAVE .....                          |  |
| HYRJE .....                                        |  |
| PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT.....  |  |
| QASJA METODOLOGJIKE .....                          |  |
| OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2025-2027 .....             |  |
| RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVË TË INTEGRITETIT..... |  |
| MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT .....          |  |
| PLANI I VEPRIMIT, 2025-2027 .....                  |  |

## **DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL**

Përballja efektive me korrupsionin për Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Shkoder është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Republikës së Shqipërisë. QTTB Shkoder zbaton programin e qeverisë në fushën e bujqësisë, në përputhje me misionin dhe objektivat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Qëllimi i QTTB është transferimi i teknologjive bujqësore, identifikimi, testimi dhe futja në praktikat bujqësore të metodave dhe materialeve të reja për vendin.

Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion. Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të QTTB Shkoder dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të transferimit të teknologjive në formën e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore, prodhimin e hallkave të larta të disa lloje farërash dhe fidanësh të çertifikuara, trajnimin i specialistëve të bujqësisë, fermerëve, studentëve të shkencave bujqësore. Jemi të ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etike, do të sigurojnë një brendësim dhe zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e fermerëve tek ne.

## **LISTA E SHKURTESAVE**

MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

MVRI – Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

QTTB – Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore

NJQP—Njësia e Qeverisjes së Përgjithshme

## **HYRJE**

Plani i Integritetit për QTTB Shkoder u hartua gjatë periudhës 26.05.2025-30.05.2025. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020. Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është:

- i) vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e QTTB Lushnje për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme dhe i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara si dhe
- ii) formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre. Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë të institucionit.

### **Këto fusha përfshijnë:**

Menaxhimin financiar;

Menaxhimin e burimeve njerëzore;

Arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve dhe informacionit;

Procedurat e prokurimit,

Transferimi i teknologjive bujqësore, identifikimi, testimi dhe futja në praktikat bujqësore të metodave dhe materialeve të reja për vendin.

Përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore, prodhimin e hallkave të larta të disa lloje farërash dhe fidanësh të certifikuara, trajnimin i specialistëve të bujqësisë, fermerëve, studentëve të shkencave bujqësore.

Menaxhimi i sektorit të laboratorit.

Menaxhimi dhe përdorimi sa më efektiv i burimeve natyrore për krijimin e të ardhurave nga Sektori i Bazës Eksperimentale/Prodhuese.

### **PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT**

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në QTTB Shkodër konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

#### ***1. Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit***

Me Urdhrin e Brendshëm nr.17, datë 26.05.2025, është ngritur grupi i punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe hartimin e Planit të Integritetit. Në përbërje të grupit të punës kanë qenë drejtori, shefa sektori të QTTB Shkoder , të cilët kanë realizuar procesin e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të integritetit, si dhe hartimin e Planit të Integritetit.

#### ***2. Identifikimi dhe analiza e riskut***

Gjatë kësaj faze, grupi i punës analizoi kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kuadrin e brendshëm rregullator për veprimtarinë e institucionit. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të QTTB Shkoder . Pjesë e kësaj analize ishin edhe të dhënat e mbledhura nga anketimi jo i strukturuar i stafit të institucionit mbi çështje të integritetit dhe etikës në

institucion si edhe për të vlerësuar njohuritë e tyre mbi kuadrin rregullator dhe struktural për integritetin në institucion.

### **3. Vlerësimi i risqeve të integritetit**

Në këtë fazë, grupi i punës vlerësoi risqet e analizuara në fazën e mësipërme duke u mbështetur në mundësinë e risqeve për të ndodhur dhe në ndikimin në rast të ndodhjes së riskut. Në vijim risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparësisë. Procesi vijoi me vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre. Në këtë fazë të procesit kontribuan të dhënat e mbledhura nga intervistat me stafin e institucionit si dhe dokumentacioni i ndodhur pranë institucionit të QTTB Shkoder .

### **4. Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut**

Grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshin masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre. Zbatimi i këtij Plani Integriteti është parashikuar për periudhën 2025-2027.

### **5.Përmbajtja e Planit të Integritetit**

Përmbajtja e Planit të Integritetit paraqitet si më poshtë:

- Deklarata e Integritetit Institucional, shprehja e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional nga ana e Titullarit të QTTB Shkoder ;
- Prezantimi i përgjithshëm i procesit të hartimit të Planit të Integritetit të QTTB Shkoder , përshkrimi i fazave të procesit të planifikimit të integritetit dhe qasja metodologjike;
- Risqet e integritetit dhe faktorët e tyre i cili përfshin një përshkrim të risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre në fushat e përgjegjësisë së institucionit.
- Plani i Veprimit, i cili përmban masat e kontrollit që duhet të ndërmerren për të adresuar risqet e identifikuara dhe të vlerësuara.

## **QASJA METODOLOGJIKE**

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në QTTB Shkoder , në përputhje me MVRI, për arsye të kohës së kufizuar për realizimin e tij, u përdor vetëm njëra nga tre metodat e përcaktuara në MVRI, pikërisht metoda cilësore - Përmes zhvillimit të intervistave dhe diskutimeve me stafin e institucionit, ku morën pjesë pjesa më e madhe e punonjësve të institucionit, sidomos punonjësit më të vjetër në profesion, si dhe përmes analizës së kuadrit rregullator të brendshëm të institucionit (rregullore të brendshme, procedura pune, plane pune, realizime projektesh në fazat aktuale etj).

## **OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2025-2027**

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Plani Integriteti, QTTB Shkoder ka vendosur katër objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2025-2027, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara. Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit institucional. Objektivat strategjikë 2025-2027, të Planit të Integritetit janë:

1. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore;
2. Zbatimi dhe realizimi në kohë I projekteve të miratuara nga MBZHR.
3. Menaxhimi dhe përdorimi sa më efektiv i burimeve natyrore për krijimin e të ardhurave nga Sektori i Bazës Eksperimentale/Prodhuese.
4. Fusha e menaxhimi të sektorit të laboratorit.

Këto objektiva strategjike bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

## **RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT**

Në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmbledhur analiza dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në QTTB Shkoder . Pas kryerjes së procesit të vlerësimit të riskut në fushat e përgjegjësisë së institucionit, rezultoi si në vijim:

### **1. Fusha e menaxhimit financiar**

Pasi u verifikua dokumentacioni financiar, rezultoi se zyra e financës çdo fillim viti harton një plan pune për të gjitha aktivitetet që lidhen me fushën e financës dhe buxhetit, për realizimin e të cilit raporton rregullisht. Po ashtu, sipas udhëzimeve përkatëse nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë hartohet brenda afateve Programi Buxhetor Afatmesëm. Të gjitha shpenzimet e institucionit përballohen me fonde nga Buxheti i Shtetit dhe një pjesë përballohet nga të ardhurat që vet institucioni krijon. Fondet buxhetore të miratuara sipas artikujve kontabël janë të mjaftueshme për realizimin e veprimtarisë së QTTB Shkoder dhe në asnjë rast nuk janë krijuar detyrime të prapambetura. Zbatimi i buxhetit vjetor monitorohet në mënyrë progresive gjatë vitit, rakordohet me Degën e Thesarit dhe raportohet edhe pranë MBZHR-së. Po ashtu, edhe të ardhurat dytësore që institucioni realizon rakordohen me Degën e Thesarit nëpërmjet situacioneve mujore. Sa i takon aktiveve afatgjata dhe qarkulluese të institucionit, rezulton se kryhet inventarizimi, vlerësimi dhe procedurat e daljes nga përdorimi të tyre sipas legjislacionit në fuqi brenda afateve të përcaktuara. Mbahet dhe përditësohet vazhdimisht regjistri i aktiveve të institucionit ku reflektohen edhe shtesat dhe pakësimet e aktiveve gjatë vitit.

- Vlerësimi i riskut të integritetit

Në këtë fushë nuk është evidentuar asnjë risk.

### **2. Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore**

Struktura e QTTB Shkoder e miratuar me VKM NR.515, date 19.06.2006 “Për ristrukturimin e institutive kërkimore-shkencore, në varësi të Ministrisë së bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit” dhe Urdhrit nr. 73, datë 30.4.2024, të Kryeministrit, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 65, datë 4.05.2015, “Për miratimin e strukturës

dhe të organikës së Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër”, është e përbërë nga 16 punonjës, nga të cilët 3 janë vende vakante.

- Vlerësimi i riskut të integritetit
- Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të ulët.

### **3. Proçedurat e prokurimit**

Lidhur me fushën e prokurimeve publike, QTTB Shkoder ngre çdo fillim viti Komisionin e Prokurimeve me Vlera të Vogla dhe me vlerën nën 100.000 lekë, i cili realizon procedurat e blerjeve. Për çdo proces të punës mbahen procesverbalët përkatës. Gjithashtu, QTTB Shkoder harton dhe miraton çdo vit regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe regjistrin e realizimit. Për të gjithë transaksionet financiare ruhet gjurma e auditit, si dhe të gjitha praktikat dhe dokumentat ruhen dhe arkivohen sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Nga verifikim i dosjeve të proçedurave të prokurimit publik, rezultoi se janë në përputhje me Ligjin e prokurimit Publik nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publi” dhe ligji 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Monitorimi i kontratave është në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas udhëzimit nr2 datë 30.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 01.09.2021” “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës” dhe udhëzimit nr.1 datë 30.12.2024 “Mbi raportimin e zbatimit të kontratës dhe miratimin e formularit të raportimit”.

- Vlerësimi i riskut të integritetit
- Në këtë fushë nuk është evidentuar asnjë risk.

### **4. Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve dhe informacionit**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga QTTB Shkoder , rezultoi se, modelet e dokumentave të përdorura nga stafi i institucionit janë të unifikuara. Gjithashtu, të gjithë dokumentat regjistrohen në regjistra dhe libra protokolli duke marrë datë dhe numër protokolli. Pranë QTTB Shkoder është ngritur dhe funksionon arkiva e institucionit, për menaxhimin e të cilës është përgjegjës Sekretarja, Arshivistja e QTTB Shkoder. Kjo ka rolin kryesor në menaxhimin e fondit arkivor të institucionit. Po ashtu, QTTB Shkoder ka ngritur Komisionin e Ekspertizës, i cili analizon të gjithë dokumentacionin që përpunon institucioni. Komisioni ka hartuar listën me afatet e ruajtjes së dokumentave në QTTB Shkoder .

- Vlerësimi i riskut të integritetit
- Në këtë fushë nuk është evidentuar asnjë risk.

### **5.Fusha e zbatimit dhe realizimit në kohë I projekteve të miratuara nga MBZHR.**

Identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen në praktikat bujqësore të metodave dhe materialeve (inputeve) të reja për vendin.

Përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore.



Kërkime dhe testime në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatës.

Trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjerë të interesuar.

·Sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët.

·Demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë.

·Përgatitjen dhe publikimin e materialeve divulgative për specialistët e bujqësisë dhe fermerët.

Mbështetjen me informacion të politikë-bërjes nga ana e MBZHR-së në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Vlerësimi i riskut të integritetit

-Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të lartë.

#### **5. Fusha e menaxhimi të sektorit të laboratorit.**

Në laborator kryen një sërë analizash për institucionin në nevojë për nxjerrjen e rezultateve për projektet.

Mungon akreditimi i laboratorit e cila jep besueshmërinë për cilësinë dhe rezultatin e analizave që kryhen në institucion.

Vlerësimi i riskut të integritetit

-Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm.

#### **6. Menaxhimi dhe përdorimi sa më efektiv i burimeve natyrore për krijimin e të ardhurave nga Sektori i Bazës Eksperimentale/Prodhuese.**

Nga verifikimi në terren dhe plan biznesit vërehet që burimet natyrore nuk janë shfrytëzuar maksimalisht nga personat përgjegjës, gjë që sjell mungesa të krijimit të të ardhurave sjell efekteve negative në kryerjen e shpenzimeve të domosdoshme për mbarëvajtjen e punëve të sektorit.

Vlerësimi i riskut të integritetit

-Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të lartë.

### **MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**

Objektivat strategjikë të këtij plani integriteti, do të implementohen nëpërmjet planit të veprimit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe të dhëna të tjera për

secilin aktivitet të parashikuar. Implementimi i planit të integritetit do të monitorohet rregullisht çdo gjashtë muaj nga Koordinatori i Integritetit në institucion. Koordinatori është përgjegjës për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit. Rezultatet e monitorimit të planit të integritetit do të bëhen publike në kuadër të praktikës institucionale të transparencës

## PLANI I VEPRIMIT 2025-2027

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së QTTB. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional. Plani ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si më poshtë:

- Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Zbatimi dhe realizimi në kohë I projekteve të miratuara nga MBZHR.
- Menaxhimi dhe përdorimi sa më efektiv i burimeve natyrore për krijimin e të ardhurave nga Sektori i Bazës Eksperimentale/Prodhuese.
- Fusha e menaxhimi të sektorit të laboratorit.

| Menaxhimi i burimeve njerëzore                                         |                                         |                            |                                                                                                                           |            |                                                                                  |                                             |                            |
|------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|----------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|----------------------------|
| Objektivi 1: Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore |                                         |                            |                                                                                                                           |            |                                                                                  |                                             |                            |
| Nr.                                                                    | Aktiviteti                              | Produkti                   | Risku dhe faktorët e riskut                                                                                               | Prioriteti | Masa për adresimin e riskut                                                      | Struktura përgjegjëse                       | Afati                      |
| 1.1                                                                    | Hartimi I hartave të proceseve të punës | Harta e proceseve të punës | Gabime të mundshme në realizimin e detyrave ditore,duke mos pasur një mjet më të strukturuar të punëve që duhen realizuar | I mesëm    | Hartimi i hartës së proceseve të punës dhe shpërndarrja tek të gjithë punonjësit | Të gjithë sektorët e QTTB Shkoder           | Deri në fund të vitit 2025 |
| 1.2                                                                    | Plotësimi I vendeve vakante             | Strukturë e plotësuar      | Pamundësi për të mbuluar të gjitha proceset e punëve përgjegjës,si rezultat mos realizimi detyrash                        | I lartë    | Kërkesë here pas here në DAP për plotësimin e vendeve vakant                     | Sektori I Financës dhe Burimeve Mbështetëse | 6 mujori I dytë vitit 2025 |

|     |                                                |                    |                                                                                                                                                                                                                                                 |         |                                                                        |                                     |                           |
|-----|------------------------------------------------|--------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------|
| 1.3 | Trajnim I vazhdueshëm I stafit te QTTB Shkoder | Staf I kualifikuar | Njohuri jo të mjaftueshme për të realizuar detyrat me cilësi,në kohë dhe sipas standarteve të duhura                                                                                                                                            | I mesëm | Hartimi I një plani të mirëkonceptuar trajnimesh në fushën e bujqësisë | ASPA në bashkëpunim me QTTB Shkoder | Fillim I vitit kalendarik |
| 1.4 | Njohje me rregulloren e re dhe kodin e etikes. | Kodi i etikes      | Mos njohja me kodin e etikes sjell pasoja si: shkeljeve e normave morale dhe ligjire, humbja e besueshmerise dhe reputacionit, sanksione disiplinore apo ligjore, demtimi i ambjentit te punes ose institucionit, ndikimi negativ te te tjeret, | I lartë | Njohja dhe veniene dijeni e kodit te etikes.                           | Drejtuesi I institucionit           | 6 mujori I dytë 2025      |

Objektivi 2: Zbatimi dhe realizimi në kohë I projekteve të miratuara nga MBZHR

| Nr. | Aktiviteti                           | Produkti                                                                                                                                                                                                      | Risku dhe faktorët e riskut                                                      | Prioriteti | Masa për adresimin e riskut      | Struktura përgjegjëse     | Afati                     |
|-----|--------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|------------|----------------------------------|---------------------------|---------------------------|
|     | Miratimi i projekteve ne kohe reale. | Kërkojmë qe projektet te miratohen ne kohe reale , te kemi përmirësime bashkëkohore në terren dhe pasije laboratorike për nxjerrjen dhe kryejen ne kohë e matjeve dhe analizave të domosdoshme për të nxjerrë | Pamundësia e realizimit në kohë të objektivit si rezultat I miratimit me vonese. | I Lartë    | Adresimi I problemit të (MBZHR,) | Drejtuesi I institucionit | Fillim I vitit kalendarik |

|  |  |                                                                         |  |  |  |  |  |
|--|--|-------------------------------------------------------------------------|--|--|--|--|--|
|  |  | një product të gatshëm sa më efektiv në formë e materialeve divulgative |  |  |  |  |  |
|--|--|-------------------------------------------------------------------------|--|--|--|--|--|

| Objektivi 3: Fusha e menaxhimi të sektorit të laboratorit.            |                                                                                                                            |            |                                  |                                                   |                           |  |
|-----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|----------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------|--|
| Produkti                                                              | Risku dhe faktorët e riskut                                                                                                | Prioriteti | Masa për adresimin e riskut      | Struktura përgjegjëse                             | Afati                     |  |
| Mobilizimi i laboratorit me paisje bashkekohore dhe akreditimi i tij. | Pamundësia e realizimit në kohë të objektivit si rezultat I mungesës së paisjeve laboraorike bashkëkohore dhe akreditimit. | I Lartë    | Adresimi I problemit të (MBZHR,) | Drejtuesi I institucionit, sektori i Laboratorit. | Fillim I vitit kalendarik |  |

| Menaxhimi i burimeve njerëzore                                                                                                                   |                                         |                                  |                                                                                                                           |            |                                                                                   |                                                                     |                                       |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|-----------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|
| Objektivi 4: Menaxhimi dhe përdorimi sa më efektiv i burimeve natyrore për krijimin e të ardhurave nga Sektori i Bazës Eksperimentale/Prodhuese. |                                         |                                  |                                                                                                                           |            |                                                                                   |                                                                     |                                       |
| Nr.                                                                                                                                              | Aktiviteti                              | Produkti                         | Risku dhe faktorët e riskut                                                                                               | Prioriteti | Masa për adresimin e riskut                                                       | Struktura përgjegjëse                                               | Afati                                 |
| 1.1                                                                                                                                              | Hartimi I hartave të proceseve të punës | Harta e proceseve të punës       | Gabime të mundshme në realizimin e detyrave ditore,duke mos pasur një mjet më të strukturuar të punëve që duhen realizuar | I mesëm    | Hartimi i hartës së proceseve të punës dhe shpërndarrja tek të gjithë punonjësit. | Të gjithë sektorët e QTTB Lushnje                                   | Deri në fund të vitit 2025            |
| 1.2                                                                                                                                              | Plan biznesi                            | Planifikimi i duhur i perdorimit | Pamundësi per paaftesi                                                                                                    | I lartë    | Planifikimi i duhur i perdorimit te                                               | Sektori I bases eksperimentale/prodhuese, Titullari i institucionit | Cdo dhjetor te viit vitit paraardhes. |

|  |  |                            |                                        |  |                                                                                                                                                                               |  |  |
|--|--|----------------------------|----------------------------------------|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
|  |  | te<br>burimeve<br>natyrore | burime<br>monetare<br>per<br>likujdim. |  | burimeve<br>natyrore dhe<br>shperndarje e<br>duhur e<br>kulturave<br>bujqesore qe te<br>realizohet dhe<br>qarkullimi<br>kulturor per nje<br>rendiment dhe<br>cilesi produkti. |  |  |
|  |  |                            |                                        |  |                                                                                                                                                                               |  |  |
|  |  |                            |                                        |  |                                                                                                                                                                               |  |  |

Grupi punes per hartimin e planit te integritetit i perbere nga:

- |                      |            |
|----------------------|------------|
| 1. Kostandin Hajkola | Kordinator |
| 2. Arzen Rexha       | Anetare    |
| 3. Mirash Markaj     | Anetare    |

